



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Glogocit
Drejtoria e Inspeksionit
Glogoc, më 23.03.2018



Për: Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, U.D Lumturije Kiqina

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit, **Aurora Berisha**

Nga: Inspektori Sanitar, **Mimoza Berisha**

R A P O R T

Për Qendrat Shëndetësore të Mjekësisë Familjare në gjithë territorin e Komunës së Drenasit

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2017 janë inspektuar 14 Qendra të Mjekësisë Familjare në territorin e Komunës së Drenasit. Me qëllim të përmirësimit të kushteve higjieniko-sanitare, në hapësirat e këtyre qendrave janë kontrolluar hapësirat e punës në të gjitha repartet, hapësirat e pritjes, nyejt sanitare, mirëmbajtja higjienike e mjeteve të punës, kontrollimi i afateve të përdorimit të barnave esenciale dhe ruajtja e tyre në temperatura përkatëse dhe zbatimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Kushtet higjieniko-sanitare në shumicën e **QSHMF-ve** janë në nivel mesatar. Në përgjithësi në disa qendra është vërejtur mungesa e punëtorëve teknik dhe mungesë e renovimeve të brendshme.

Në vazhdim po i paraqesim vërejtjet të cilat i kemi hasur gjatë inspektimit për së cilën qendër (QSHMF) :

- 1. QKMF-Drenas**, gjatë inspektimit të bërë kësaj qendre me dt. 01.12.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin mesatar në përgjithësi, mirëpo në repartin e pediatriisë dhe barnatores kemi hasur në shenja të brejtësve, që mund të vije si pasojë e mungesës së D.D.D (Dezinfektim, dezinfektimi dhe deratizimi të kësaj hapësire). Në disa reparte mungojnë shportat dhe qeset për hedhjen e mbeturinave, e në disa reparte ka

probleme teknike me qeshmet e ujit dhe ka mungesë të punëtoreve teknik. Në repartin e maternitetit, në disa pjesë të mureve është dëmtuar gëlqerosja dhe ka qarje të murit në disa vende.

Në këtë qendër janë vetëm dy tualete në shërbim të pacientëve, që nuk janë të mjaftueshme. REKOMANDIM: I rekomandohet DSHMS-së që të ndërmer veprimet e nevojshme dhe të lëshojë në përdorim për pacientë njejt sanitare në çdo kat të objektit, pasi njejt sanitare në katet e sipërme përdoren vetëm nga stafi, ndërsa qëndrojnë mbyllur për pacient.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë kësaj qendre me dt.21.04.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë në nivelin e duhur në përgjithësi në këtë qender, përkatësisht në repartin e gjinekologjisë kemi hasur në papastërti sidomos në dhomat e lehonave, në disa prej tyre mungonte uji, në disa pjesë të mureve është dëmtuar gëlqerosja, janë paraqitur qarje në muri në disa vende, mungesë e mjeteve higjenike (shampon për duar, letër higjenike etj.), mungesë e puntorëve teknik (në këtë repart ka vetëm një puntor teknik). Pas vërejtjes së dhënë kushtet higjenike janë përmirësuar, mirëpo kushtet teknike si: gëlqerosja, mjetet higjenike dhe mungesa e punëtorve teknik ka mbetur ende e pa zgjidhur.

Në këtë qender janë vetëm dy njeje sanitare në shërbim të pacientve dhe përcjellësve tyre, që nuk janë të mjaftushme, edhe pse në çdo kat ka njeje sanitare por qëndrojnë të mbyllura. Gjithashtu, në disa hapësira të kësaj qendre është hasur në shënja të pirjes së duhanit, siç janë: mjete improvizuse dhe mbetje të duhanit, si dhe dhoma e punëtorve teknik që ndodhet afër repartit të emergjencës, ka qenë e tymosur.

2. **QMF-Terstenik**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 30.11.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar në përgjithësi. Ka mjete higjenike të mjaftueshme, ka punëtor teknik për mirëmbajtjen e kësaj qendre dhe është duke u respektuar Ligji për Kontrollin e Duhanit.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qender me dt.23.02.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar në përgjithësi dhe është duke u respektuar Ligji për Kontroll të Duhanit.

3. **QMF-Komoran**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 29.11.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë në nivel të duhur, përkatësisht ka defekte teknike në njeje sanitare, nuk është bërë asnjëherë D.D.D (dezinfektim, dezinsektimi dhe deratizimi) dhe si pasojë janë paraqitur brejtës (minj), gjithashtu objekti është i vjetruar pa renovime të brendshme për një kohë të gjatë. Në këtë qendër është duke u respektuar Ligji për Kontrollin e Duhanit.

REKOMANDIM: i rekomandohet DSHMS-së që të bëjë D.D.D e objektit.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.23.02.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivel mesatar edhe pse objekti është i vjetëruar. Në këtë qendër është duke u respektuar Ligji për Kontroll të Duhanit.

4. **QMF-Arllat**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 04.12.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar në përgjithësi. Ka mjete higjienike të mjaftueshme, ka punëtor teknik për mirëmbajtje, mirëpo çarçafët duhet të ndërrohen rregullisht dhe të jenë higjenik, nuk duhet të përdoren për tharjen e duarve riza (peshqirë), por ato duhet të zëvendësohen me letër higjienike. Ligji për Kontrollin e Duhanit është duke u respektuar.

Gjendja paraprake

Në këtë qendër në muajin qershor 2017 objekti ka qenë në renovim.

5. **QMF-Baicë**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 06.12.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar, mirëpo kushtet teknike nuk janë të kënaqshme pasi që objekti është i vjetërsuar. Dyert dhe dritaret janë të dëmtuara dhe të vjetërsuar, depërton lagështia gjatë muajve të dimrit dhe krijon myk, dyshemeja është në gjendje të keqe dhe vështir të mirëmbahet, plafoni i kësaj qendre është prej materialit të quajtur tërskë i cili krijon papastërti, nyejt sanitare brenda objektit për pacient janë jashtë funksionit pasi nuk ka ujë dhe janë të dëmtuar gypat (nga ngricat), gjatë periudhës së dimrit nyejt bëhen jo funksionale për shkak të ngrirjes së gypave të ujit pasi ata janë të pa izoluar, pacientët përdorin banjo fushore që ndodhen jashtë objektit, gjithashtu ka mungesë të materialit higjenik.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.02.05.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivel mesatar, mirëpo kushtet teknike nuk janë të kënaqshme pasi që objekti është i vjetëruar. Dyert dhe dritaret janë të dëmtuara dhe të vjetëruar ku depërton të ftohtit dhe lagështia gjatë muajve të dimrit, dyshemeja është në gjendje të keqe, pllafoni i kësaj qendre është prej materialit të quajtur tërsk i cili krijon papastërti brenda objektit, nyejt sanitare brenda janë jashtë funksionit për arsye se nuk ka ujë dhe janë të dëmtuar gypat nga ngricat, pacientët dhe stafi i qenderës përdorin banjo fushore që ndodhen jashtë objektit, gjithashtu ka mungesë të materialit higjenik.

6. **QMF-Gllanasellë**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 06.12.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar. Objekti është i vjetërsuar që e vështirëson mirëmbajtjen e higjienës, muret janë të tymosura dhe kanë nevojë për gëlqerosje, dritaret dhe dyert janë të dëmtuara dhe depërton lagështi, ka mjete higjienike të mjaftueshme, çarçafët janë të pastruar, barnat janë më afat të përdorimit dhe mjetet e punës janë të sterilizuara, mirëpo njëra nyje sanitare është jashtë funksionit për shkak të disa problemeve të vogla teknike të cilat duhen të evitohen në mënyrë që të funksionalizohet kjo nyje.

REKOMANDIM: i rekomandohet DSHMS-së që të bëjë ndërrimin e dyerve, dritareve dhe të behet gëlqerosja e mureve ku është e nevojshme.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.23.03.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivel mesatar, mirëpo muret janë të pa gëlqerosura dhe ka reduktime të ujit.

7. **AMF-Abri e Epërme**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 05.12.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar. Objekti është i vjetërsuar, dritaret janë nga druri dhe janë në gjendje të keqe ku depërton lagështia gjatë dimrit, muret në dhomën e injeksioneve kanë nevojë të gëlqerosen, nyejt sanitare kanë nevojë të mirëmbahen rregullisht, por punëtori teknik punon vetëm dy ditë në javë, që nuk është e mjaftueshme për mbajtjen e nivelit të higjienës në baza ditore. Pacientet të cilët marrin shërbime nga kjo qendër i parkojnë veturat në rrugën kryesore pasi që nuk ka parking të objekti i ambulantes.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.05.04.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë në nivelin e duhur. Objekti është i vjetëruar, dritaret janë nga druri dhe janë në gjendje të keqe ku depërton te ftohetit gjatë dimrit muret në dhomën e injeksioneve janë të tymosura nga tymi që ka liruar stufa me të cilën ngrohen gjatë dimrit, objektin dhe kjo dhomë është e pa gëlqerosur, nyjet sanitare kanë nevojë të pastrohen çdo ditë mirëpo punëtori teknik nuk punon çdo ditë në këtë qendër.

8. **AMF-Terdec**, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 06.12.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë në nivelin e duhur. Nyejt sanitare janë të dëmtuara ku rrjedh uji nga guaska në dysHEME, muret në dhomat e injeksioneve kanë nevojë për gëlqerosje.

9. **Gjendja paraprake**

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.02.05.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë në nivelin e duhur. Nyjet sanitare janë të dëmtuara ku rrjedh uji

nga guacka në dysHEME, dhoma e ineksionëve është e pa gëlqerosur, në hyrje të kësaj qendre ka veshitësi të hyrjes për pacient, gjithashtu kemi hasur në barna esenciale me afat të skaduar të përdorimit.

- 10. AMF-Gradicë,** gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 06.12.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin mesatar, përkatësisht dysHEMEja me pllaka qeramike është e mirëmbajtur mirë, por në njejt sanitare guaskat duhet të pastrohen më mirë dhe rregullisht, në disa pjesë muret janë të pa gëlqerosura, në korridore janë të vendosura shenjat për ndalimin e duhanit, çarçafët janë të pastër dhe higjienik, por punëtori teknik punon vetëm dy ditë në javë, që nuk është e mjaftueshme për mbajtjen e nivelit të higjienës.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.12.05.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivel relativisht mesatar, përkatësisht njëra nga nyjet sanitare sepse ka të dëmtuar guacën nga e cila rrjedh uji në dysHEME.

- 11. AMF-Dobroshec,** gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 27.11.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin mesatar. Muret janë të pa gëlqerosura dhe inventari është i dëmtuar pjesë – pjesë, shportat për hedhjen e mbeturinave mungojnë, lavamani në dhomën e injeksioneve ka defekte dhe rrjedh uji në dysHEME.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.12.05.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin mesatar. Muret janë të pa gëlqerosura, inventari është i dëmtuar pjesë–pjesë dhe mungojnë shportat për hudhjen e mbeturinave brenda objektit.

- 12. AMF-Vasilevë,** gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 05.12.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare nuk janë në nivelin e kënaqshëm. Në nyje sanitare pllakat e murit të cilat kanë mbetje të ngjyrës (polikolorit) kanë nevojë të pastrohen, në disa pjesë të murit ka merimanga, në këtë qendër mungon punëtori teknik, ndërsa për mirëmbajtjen e objektit kujdeset motra medicinale.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.08.05.2017 është konstatuar se kushtet higjieniko-sanitare janë në nivelin e kënaqshëm. Në këtë qendër mungon punëtori teknik, ndërsa për mirëmbajtjen e objektit kujdeset motra medicinale

13. AMF-Nekoc, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 29.11.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë nivelin mesatar, mirëpo dhoma e barnave ka lagështi dhe është formuar myku, po ashtu në këtë qendër nuk ka punëtor teknik për mirëmbajtje të objektit.

Gjendja paraprake

Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.12.05.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare nuk janë nivelin e duhur. Në këtë qendër ka mungesë të ujit për pije dhe pastrim, pasi uji që përdoret është i pa pastër, nuk mund të përdoret për pije dhe për pastrimin e duarve sepse stafi deklaron që është uji infektues, dhoma e mjekut është e pa gëlqerosur dhe dyshemeja nga goma është e dëmtuar në skaje dhe njëra nga nyjet sanitare është jashtë funksionit për shkak se janë të dëmtuara elementet e saj. Gjithashtu në këtë qendër ka mungesë të puntorëve teknik sepse këtu punëtori vjen vetëm dy herë në javë.


14. AMF-Sankoc, gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt. 29.11.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë në nivelin mesatar. Në këtë qendër dyshemeja është nga llastiku që është në gjendje të keqe, muret janë të pa gëlqerosura, nyjet sanitare janë të dëmtuara dhe nuk ka punëtor teknik për mirëmbajtje.



Gjendja paraprake



Gjatë inspektimit të bërë në këtë qendër me dt.06.06.2017 është konstatuar se kushtet higjeniko-sanitare janë nën nivelin e duhur. Kjo qendër nuk i plotëson kushtet minimale për arsye se: dyshemeja është nga llastiku dhe në gjendje të keqe, muret janë të pa gëlqerosura, nyjet sanitare janë të pa pastruara dhe të dëmtuara, shtrati në dhomën e ineksioneve është i dëmtuar tërësisht, në njërin nga dhomat kundërmon erë e keqe dhe oborri i kësaj qendre nuk është i mirëmbajtur, përkatësisht bari është i pa kositur që paraqet rrezik nga gjarpërinjet, punëtori teknik punon dy herë në javë, ndërsa mirëmbajtja higjenike duhet të jetë e rregullt ditore.


15. QMF-Negroc, kjo qendër nuk është funksionale si dhe nuk ka qenë as gjatë tërë vitit.



PARAQITJA GRAFIKE E GJENDJES SË KUSHTEVE SANITARE DHE TEKNIKE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE






















REKOMANDIM

Nga kjo që u tha më lartë dhe nga gjendja faktike e qendrave të mjekësisë familjare, si dhe në bazë të kapacitetit me punëtor teknik dhe mundësive buxhetore inspektoriatit sanitar komunal me qëllim të përmirimit të vazhdueshëm të kushteve higjienike, teknike dhe sanitare në bazë të kompetencave të Ligjit Sanitar të Kosovës dhe normave sanitare të aplikushme, DSHMS si organ menaxhues i këtyre qendrave, inspektori sanitar i jep këto rekomandime:

-Të vendosen shporta për hudhjen e mbeturina në secilën nga kabinat e nyjeve sanitare dhe hapësirave tjera siç janë : në hyrje të objekteve, koridoreve dhe në dhoma të punës.

- Të kyqen në sistemin e menaxhimit të mbeturinave qendrat që nuk janë të kyqura në këtë sistem (pasi që shumica absolute nuk janë të kyqura).

- Sipas mundësive të sigurohen punëtor teknik për mirëmbajtjen e qendrave në Nekoc, Sankoc, Abri e Epërme, Terdec, Gradicë .

-Të gëlqerosen muret e qendrave në Nekoc, Gllanasellë, Abri e Epërme, Terdec dhe Gradicë.

- Të bëhet pastrimi i rregullt i qarqafave për pacient në të gjitha repartet si dhe uniformat e personelit mjeksor, të furnizohen me leter higjienike të mjaftushme për fshirjen e duarve dhe në të njëjtën kohë të bëhet largimi i rizave (peshqirët).

-Të bëhet ndërrimi i dyerve dhe dritareve sepse janë të vjetëruara dhe gjatë periudhës së dimrit depërton të ftohtit dhe lagështia, në këto qendra Baicë, Gllanasellë, Abri Epërme dhe Sankoc.

1. Në QKMF-në e Drenasit- të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe të lëshojë në përdorim për pacientë nyjet sanitare në çdo kat të objektit, pasi nyjet sanitare në katet e sipërme përdoren vetëm nga stafi, ndërsa qëndrojnë mbyllur për pacient dhe kërkohet të bëhet D.D.D e objektit.